



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0671

Nr. 2023/0671

2023/0675

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092), si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës 01/2020, e amendamentuar me 09. 08. 2023, në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "AGS Corporation SH.P.K" Nr. 671/23, dhe ankesës së OE "Pro Medical" SH.P.K. Nr. 675/23, kundër Vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së" me numër të prokurimit 206-23-4215-1-1-1, inicuar nga Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK), më 21/11/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesat e OE "AGS Corporation" SH.P.K, me nr. 2023/0671 e datës 08/09/2023, vendimi për dhënie për LOT 7, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së", me numër të prokurimit 206-23-4215-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë, ndërsa aktiviteti i sipërcituar i AK-se, **mbetet në fuqi**.

2. **Aprovohet**, pjesërisht e bazuar OE "Pro Medical" SH.P.K. me nr. 2023/0675 e dates 10/09/2023, vendimi për dhënie për LOT 10 dhe 14, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së", me numër të prokurimit 206-23-4215-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë, anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit për LOT 10 dhe 14 **kthehet në ri-vlerësim**.

3 Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatoreve ekonomik ankues "AGS Corporation" SH.P.K, i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

4. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimit të ankesës, me ç'rast Ankuesit "Pro Medical" SH.P.K, duhet të paraqes kërkesë për kthimin e mjeteve brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP;

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 04.05.2023, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” me numër të prokurimit 206-23-4215-1-1-1.

Me 21.08.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për dhënie të kontratës.

Me 25.08.2023, OE “AGS Corporation” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 27.08.2023 po ashtu edhe OE “Pro Medical” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me datën 30. 08. 2023, AK me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE “AGS Corporation” Sh.P.K. Me datën 01. 09. 2023, AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE “Pro Medical” Sh.P.K.

Me 08.09.2023, OE “AGS Corporation” Sh.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 671/23 ndërsa me datë 10.09.2023 OE “Pro Medical” Sh.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 675/23.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 671/23 dhe ankesa nr. 675/23 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AGS Corporation SH.P.K" janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I):* Ne njoftimin për vendimin e autoritetit kontraktues, jemi njoftuar që jemi eliminuar nga LOT7 për arsye që komisioni nuk i ka evidentuar disa finesa teknike nga specifikimi teknik, pra duke qene se jemi rreth 9.000 EUR me lire se OE i propozuar për Kontrate (Ku komisioni i AK me ose pa dashje dëmton buxhetin e shtetit), mendojmë që

është shkelur neni 72 i LPP sepse nuk na janë kërkuar fare sqarime shtese qe parashihen ne këtë nen.. Rrjedhimisht finesat për te cilat komisioni i supozon qe nuk përputhen qe te gjitha mund te gjenden dhe ne publikimet shkencore te prodhuesit European OPTOPOL te cilat janë dhe te qasshme online e me se miri do te ishin afruar tek Komisioni sikur te respektohej neni 72 I LPP dhe te na kërkoreshin sqarime shtese qe i obligon LPP. Me kërkesë zyrtare na është mundësuar qasja ne dokumentet e fituesit te këtij LOT7 e qe vlen te ceket qe qasja ka qene profesionale dhe na është ofruar çdo material qe kemi kërkuar e qe na mundësohet me LPP. Gjate vlerësimit te dokumentacionit zyrtarisht te marrur nga AK, vërejmë se Komisioni ka bere shkelje flagrante gjate vlerësimit, ku ka propozuar për kontrate OE e cili nuk e ofron gati gjysmën e pajisjes e kërkuar sipas specifikacionit teknik, pra komisioni propozon për kontrate OE i cili nuk është i përgjegjshëm.

- *Pretendimi i dytë (II):* Te gjeturat teknike gjate qasjes ne dokumentet zyrtare te OE te propozuar për Kontrate: PIKA 1-OE i propozuar për kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit OCTOPUS 900 Pro, por nuk ka ofertuar për aksesorin si me poshtë: LOTI 7, perimetër automatizuar - UPS, tabelë e motorizuar, bateri rimbushëse - UPS, karrige për ekzaminues dhe pacient. Tavolinë e motorizuar, lartësia e rregullueshme e së njëjtës markë me rrota vogla të rrotullueshme me frena, këllëf paketimi (1), përshtatës elektrik (1) -1 set. OE nuk e ka dëshmuar ofertimin e këtij aksessori (tavoline) si kërkesë teknike e detyrueshme dhe si i tille OE është i papërgjegjshëm. Pika 2. OE i propozuar për kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit OCTOPUS 900, por nuk ka ofertuar për aksesorin si me poshtë: Loti 7 Perimetër i Automatizuar - UPS, Tabelë E Motorizuar, Bateri rimbushëse - UPS, Karrige për Ekzaminues dhe Pacient. Karrige rrotulluese -1 copë. OE nuk e ka dëshmuar ofertimin e këtij aksessori (karrige) si kërkesë teknike e detyrueshme dhe si i tille OE është i papërgjegjshëm. PIKA 3. OE i propozuar për kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit Octopus 900, por nuk ka ofertuar për aksesorin. PIKA 4. OE i propozuar për kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit Octopus 900, por nuk ka ofertuar për aksesorin si me poshtë: LOTI 7, perimetër i automatizuar - UPS, tabelë e motorizuar, Bateri rimbushëse - UPS, karrige për ekzaminues dhe pacient. E pajisur me bateri të rikarikueshme - UPS: autonomi > 30. OE nuk e ka dëshmuar ofertimin e këtij aksessori (UPS A UTONOMI> 30) si kërkesë teknike e detyrueshme dhe si i tille OE është i papërgjegjshëm. Pika 5. OE i propozuar për kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit OCTOPUS 900, por nuk ka ofertuar për piken si me poshtë: Pajisja dhe Softueri Softuer me përditësime të pakufizuara dhe antivirus me përditësime të pakufizuara. OE nuk e ka dëshmuar ofertimin e antivirusit apo te ndonjë forme tjetër te sigurisë softuerike pasi qe dhe oferta nuk përmban kompjuter i cili domosdoshmërisht jep qasje ne siguri softuerike pra kjo kërkesë teknike e detyrueshme nuk është përmbush dhe si i tille OE është i papërgjegjshëm. Pika 6. OE i propozuar për kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit OCTOPUS 900, por nuk ka nënvizuar katalogun siç kërkohej ne FDT e qe ilustron me poshtë: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: Kërkesa 2. Operatori ekonomik te prezantoj katalogun (broshurën) e pajisjeve te ofruara dhe te nënvizohen ne mënyrë te qarte produktet dhe specifikat teknike te ofruara. Nëse ofrohet broshura, duhet te specifikohet linku i ueb faqes. Vlen te ceket qe AK, ne mënyrë arbitrare ka bere vlerësimin e këtij tenderi ne mënyrë sipërfaqësore, e ajo me interesante është se kalohen 2 operatore me te lire dhe nuk kërkohej fare sqarim sipas Nenin 72, për pikat qe AK decitivisht mendon qe nuk gjenden ne katalog, e po te cilat konfirmohen nga ana e ynë me Deklarate e ne rast se do te zbatohet ligji do te pranonin dhe informatat shkencore ne pikat qe AK mendon qe nuk i plotësojmë, por AK ne mënyrë arbitrare e qe besa duke cituar termet ne gjuhen angleze qe mund te jene marrur copy/paste nga dikush qe favorizon një OE te caktuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Pro Medical" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I):* AK- Ministria e Shëndetësisë ne aktivitetin e prokurimit Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative te QKUK-së” LOTI 10 dhe LOT 14 AK ne aktivitetin e prokurimit te lartshënuar ka bere Njoftimin mbi Vendimin e AK-se me datën 21.08.2023 , ku LOT 10 është anuluar, kurse për LOT 14 ka shpërblyer me kontrate OE “MEDITECH”. Neni 1- Qëllimi- E kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues ngase i njëjti është në kundërshti me nenin 1 te Ligjit për Prokurim Publik dhe paragrafin nuk ka marre ne konsiderate detyrimin. AK në këtë rastin tonë ka shkelur Nenin 1 paragrafin 2 të LPP citim “Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji” Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi- Ky nene është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, por ne kemi vërejtur se nuk jemi trajtuar si barabartë nga AK ku ne vijmë do paraqesim fakte dhe dëshmitë gjithashtu edhe pretendimet tona ankimore Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve- AK nuk ka respektuar LPP gjatë vlerësimit të ofertës tonë. Por AK ishte i obliguar të merrte parasysh Ligjin e Prokurimit Publik (LPP), përfshirë Nenin 72 dhe Nenin 59.2. Megjithatë, duke mos kërkuar informacion shtesë nga AK, AK ka bërë një vlerësim që në kundërshtim me LPP, dhe duke pasuar si qëllimin për eliminimin e ofertës tonë LOT 10. Në këtë pikë, dëshirojmë të informojmë se AK-në si vijon dhe arsyetimet i eliminimit tonë është kundërshtime me parimet bazë LPP të cekur më lartë. Lidhur me LOT 10 ne do të bëjmë arsyetimin dhe do të argumentojmë se paisja jonë i plotëson dhe tejkalon specifikacionet teknike të kërkuar nga AK apo NJK dhe oferta jonë është konfrom sqarimeve te AK të datës 26.05.2023 pra pretendimet tone për LOT 10 do jenë të bazuar në dëshmi, fakte dhe prova relevante por AK duhet te ketë parasysh sqarime e datës 26.05.2023.
- *Pretendimi i dytë (II):* Pretendimi i pare ankimor për Lot 10 - Furnizim me pajisje mjekësorë për Klinikës e Oftalmologjisë Ne kemi vënë re sa komisioni vlerësues ka bërë disa gabime/devijimeve në vlerësimin e ofertës tonë nga sqarimet e datës 26.05.2023, dhe dëshirojmë tju japim shpjegime të sakta dhe të plotësisht të qartësuara për arsyet e këtyre gabimeve nga komisioni vlerësueses ne jemi eliminuar edhe pse AK/NJK kanë dhe sqarime me datë 26.05.2023. AK ne Letër Standarde për OE Eliminuar 21.08.2023 është cekur arsyet eliminimit janë si më poshtë për LOT 10. Mungojnë specifikat teknike ne katalogun e ofertuar: Joystick Peratio ose Funkzioni i levës (shqip) Target: Fixation Light ose Objektiva: Drita fiksuese (shqip) -Arsyejet e eliminimit të tonë (Pro Medical) nga komisioni vlerësues i AK nuk qëndron sepse në vijim do të argumentoj se arsya e eliminimit është i paarsyeshëm dhe i pa i bazuar për: Joystick Peratio ose Funkzioni i levës (shqip): Ne për LOT 10 me paisjen e ofertuar kemi plotësuar dhe tejkaluar kërkesa e AK pra NJK sepse kemi ofertuar me paisjet shumë avancuar se sa kërkesat teknike në DT, pra ne kemi ofertuar me paisje më të avancuara pra siç është cekur edhe në sqarime AK or better, or higher pra paisja jonë e ofertuar për LOT 10 pra Crystalvue TonoVue nuk ka - Operim me Joystick, sepse pajisja është me një ekran prekës lcd 10.1 inç dhe të gjitha veprimet bëhen me një prekje të vetme, jo në mënyre manual pra klasike me operim me joystick, pra paisja jonë është me e avancuar e cila të gjitha veprimet i kryen shumë thjesht dhe më precizitet të lartë, se me operim me

joystick, si kemi theksuar me lart, pra paisja jone që kemi ofertuar është me e avancuar dhe të gjitha veprimet kryen vetëm në një mënyrë shumë të thjeshtë dhe të saktë, duke e bërë kështu operimin me joystick të panevojshëm, pra paisja jonë është fully automated non-contact ose shqip plotësisht i automatizuar pa kontakt pra e teknologjia me të avancuar. këtu është videoja e paisjes tonovue: ku të gjitha veprimet janë plotësisht i automatizuar pa kontakt pra e teknologjia me avancuar, kështu operimin me joystick është i panevojshëm.

- *Pretendimi i tretë (III):* arsyejet e eliminimit të OE Pro Medical nga komisioni vlerësues i AK nuk qëndron sepse në vijim do të argumentoj se arsyeja e eliminimit është i paarsyeshëm dhe i pa i bazuar për: target: fixation light ose objektiva: drita fiksuese (shqip): paisja jona e ofertuara pra crystalvue tonovue nuk ka përkufizim: dritë fikse sepse teknologjia me avancuar bënë me ndjekja 3d. thjesht shiko në qendër, pajisja do të nisë /lëvizë me një prekje të vetme. këtu është videoja e produktit. Duke i plotësuar dhe tejkualuar këto specifikacione teknike, parametra dhe duke marr parasysh këto performancat të teknologji më të avancuar, pajisja jonë ofron një performancë të jashtëzakonshme dhe ndryshon për më mirë sfidën e të kryerit të shërbimeve me pajisje të fundit teknologjike në këtë fushë. Me teknologjinë më të fundit, paisja jonë ofron një performancë më të përparuar dhe e përmbush me lehtësi kërkesat e shërbimeve lidhur me paisjen ne LOT 10. Në lidhje me LOT 10, paisja jona e ofertuara ka plotësuar dhe tejkualuar kërkesat e NJK dhe AK. Ne kemi ofertuar pajisje që janë shumë më të përparuara se kërkesat e përcaktuara në DT, kurse komisioni vlerësues nuk e ka vlerësuar këtë përparësi dhe pse e ka bërë të ditur në sqarimet e tyre se pranohen paisjet me më mirë, ose më lart (better, or higher) pajisja jonë për LOT 10 Duke pasur parasysh këto përfitime të paisjeve të avancuara, ne kemi kërkuar nga AK/NJK që të kryejë një vlerësim profesional në përputhje me sqarimet e datës 26.05.2023 dhe të konsiderojë performancat më të përparuara që ofron paisja jonë, por AK ka refuzuar Kërkesën tonë. Ky vlerësim do të siguronte një përputhje të qartë midis avancimeve teknologjike dhe nevojave të interesit publik shëndetësor Neni 28 - Paragrafi 6 i këtij neni te LPP thotë se: “Nëse një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluara duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni. Ne baze të dëshmive, provave dhe faktet ne si OE duhet të rekomandohemi për kontratë për LOT 10, kurse AK ka anuluar LOT 10 edhe pse ne kemi plotësuar specifikacione teknike dhe kemi tejkualuar ato, ndoshta qëllimi i AK është që këtë LOTO të ridërgoj në ri tenderim që ti jap rast OE të favorizuar përsëri dhe ta shpërblej me kontratë. Pretendimi i dytë ankimor për Lot 14 - Furnizim me pajisje mjekësore për Kl. e Oftalmologjisë Ne si OE për LOT 14 nuk kemi pranuar nga AK LS për tenderues të pasuksesshëm, por në bazë raportit të vlerësimit ne jemi të pasuksesshëm kurse AK ka rekomanduar për kontratë OE “MEDITECH” për LOT 14 në kundërshtime me Neni 59 të LPP. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve- AK nuk ka respektuar LPP gjatë vlerësimit të ofertës të OE të rekomanduar për kontratë, në vijim do ilustrojmë se pse ky OE duhet të eliminuar dhe jo rekomanduar për kontratë siç ka vepruar AK. Specifikacionet teknike dhe kërkesat e AK për LOT 14 kanë qenë cekura si më poshtë: Loti 14- Auto-Kerato-Refraktometër - Ups, Tavolinë e Motorizuar, Karrige për Kontrolluesin dhe Pacientin – 5 copë. Sipas Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme Aksesorë 1. Tavolinë e motorizuar, që i përshtatet lartësia e markës së njëjtë me rrota të vogla me frena, me këllëf paketimi (1), përshtatës elektrik (1) - 1 set 2. Karrige rrotulluese - 1 copë. 3. Karrige pacienti me përshtatje të lartësisë - 1 copë. 4. E pajisur me bateri që rimbushen -

UPS: autonome ≥ 30 minuta OE nuk ka dëshmuar ofertimin e këtyre aksesoreve të listuar më lart si në pikat 1,2,3 dhe 4 të cilat janë si kërkesë teknike e detyrueshme sipas Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme dhe si i tillë OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm. Kurse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar për Aksorë asnjë katalogu, specifikacion teknik, foto apo ndonjë dëshmi se çfarë (pozicioni 1) tavoline ka ofertuar elektrike /mekanike/.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 29.06.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 671/23 dhe 675/23 ndërsa me datë 15.09.2023 Paneli Shqyrtues ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore.

Per ankesën nr. 671/23 me datë 25.09.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, të anulohet njoftimi i AK-së për aktivitetin e prokurimit dhe rekomandon që vendimi i AK-së të mbetet në fuqi”*.

Lidhur me ankesën nr. 675/23 me datë 25.09.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me Nr. 2023/0675 me rekomandimet si në vijim: *“eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, të anulohet njoftimi i AK-së për aktivitetin e prokurimit dhe rekomandon që vendimi i AK-së të mbetet në fuqi”*.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK ka deklaruar se pajtohet. Me 02.10.2023 OE “AGS Corporation SH.P.K.” ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimet e në raportin e ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0671, ndërsa AK ka deklaruar se pajtohet në po të njëjtën datë. Me 02.10.2023 edhe OE “Pro Medical” SH.P.K. ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimet në raportin e ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0675, duke e kundërshtuar fuqishëm dhe në jo profesionalizëm të ekspertit shqyrtues, atëherë, paneli shqyrtues vendosi që për shqyrtim të ankesës 2023/0675 të kërkoj një super ekspertizë. Me çrast eksperti shqyrtues ka dorëzuar më dt. 07.11.2023, raportin e super ekspertizës duke rekomanduar që: " Duke u bazuar në të gjeturat, krahasimet, faktet, dokumentet e shqyrtuara dhe të cekura në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues i prokurimit i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e **bazuar** dhe që Paneli Shqyrtues i OSHP-së të sjellë vendim për mbetje në fuqi të vendimit për anulim të **LOT 10** dhe vendim për anulim të njoftimit për shperblim me kontratë për **LOT 14** dhe kthim të aktivitetit të prokurimit (LOT 14) në **rivlerësim**".

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportet e ekspertëve, mendimet e palëve lidhur me raportet e ekspertëve, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “AGS Corporation” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0671 ka vlerësuar si në vijim:

- *Konstatimi i parë (I):* OE “AGS Corporation” SH.P.K është i papërgjegjshëm për Lotin 7 pasi që nuk i plotëson specifikat teknike të detyrueshme të kërkuara në dosje të tenderit për pajisjen e ofruar. Andaj AK –MSH ka vepruar konform nenit Neni 59 të LPP, duke rekomanduar si oferte të papërgjegjshme ofertën e OE AGS Corporation SH.P.K, për mosplotësim të specifikave teknike të pajisjeve të ofruara. Sa i përket pretendimeve të tjera të radhitura të OE “AGS Corporation” Sh.p.k., se OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka prezantuar katalogun e nënvizuar dhe pajisjet përcjellëse, këto pretendime janë të paqëndrueshme sepse OE ka prezantuar komplet Specifikat teknike të pajisjeve. Ka ofruar katalogun e pajisjes në fjale, ndërsa për aksesoret shtese ka prezantuar deklaratë me shkrim se të gjitha pajisjet përcjellëse (aksesoret) do të ofrohen konform kërkesave të dosjes së Tenderit. Pra vlen të përmendet se kriteri për katalogun/broshurën ka qene për pajisjet e jo për aksesoret shtese, siç janë: karriget, tavolina, UPS, etj, pasi që në dosje të tenderit për këto aksesore nuk janë kërkuar specifikime të detajuara. OE i rekomanduar ka deklaruar me shkrim dhe është i obliguar që gjatë liferimit të pajisjeve, do të sjellë edhe pajisjet shtese sipas siç janë kërkuar. Oferta financiare e OE të rekomanduar përfshinë pajisjet dhe aksesoret shtese, kjo dëshmohet me deklaratën e dhënë në ofertë. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertëve shqyrtues/teknik janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AGS Corporation” SH.P.K i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues dhe teknik. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjet e palëve lidhur me raportin e ekspertit dhe përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të bazuara.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Pro Medical” Sh.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit të super ekspertizës nr. 2023/0675 ka vlerësuar se:

- *Konstatimi i parë (I):* Për lot 10: Eksperti shqyrtues i prokurimit pas shqyrtimit të kërkesës në Aneksin 1, sqarimeve të bëra nga AK me datë 26.05.2023, ofertës së dorëzuar nga OE ankues dhe duke u bazuar edhe në faktet 2 dhe 3 të bashkëngjitura me lartë në këtë ekspertizë, konstaton se OE ankues për LOT 10 ka ofertuar me pajisjen e prodhuesit “**Crystalvue Medical Corporation**” nga Taiwani – Kina, modeli “**Tonovue Fully Automated Non-Contact Tonometer**”, që është pajisje që përdoren zakonisht për matjen e shtypjes së brendshme të syrit të njeriut dhe mbrojtje nga Glaukoma. Janë kërkuar 5 copë aparatura të tilla. OE ankues ka bashkëngjitur në ofertën e tij specifikacionin e detajuar teknik, CE certifikatat valide, autorizimin nga prodhuesi, listen e pjesëve rezervë, deklarinimin për garancion, të gjitha këto në përputhje me kërkesat e paraqitura në DT dhe Aneksin 1 dhe të paraqitura si fakt 1 në këtë ekspertizë. OE ankues në dosjen e tij e ka të bashkëngjitur edhe dokumentin me titull: **Kerkesa 2. Katalogun me specifikacione teknike për pajisjet të ofruara LOT 10**, në të cilin janë të detajuara specifikat të cilat i plotëson produkti kryesor dhe aksesoret/pajisjet shtesë të tij. Duke marrë parasysh edhe përgjigjen e

AK-së ku lejon teknologji me te avancuar gjë që është në pajtimin me LPP-në, e konfirmoj qe pajisja e ofertuar nga OE ankues i plotëson kërkesat minimale, dhe po ashtu që posedon teknologji me të avancuar se sa ajo e kërkuar në aneksin 1. Funkzioni i levës është zevëndësuar me pajisje me ekran me prekje dhe fokusim përmes “*touch screen*” ndërsa për pjesën “*Objektivi – Drita fiksuese*” është e zevëndësuar me teknologjinë “*3D tracking*” dhe pasi që këto dy mos përputhje me kërkesën specifike, mund të konsiderohen si të zevëndësuar me veçori me të avancuara, që është në përputhje me kërkesën për sqarim të bashkëngjitur **si Fakt 2** në këtë ekspertizë. Eksperti shqyrtues i prokurimit këtë pretendim e kish propozuar qe te aprovohet si i bazuar vetëm në rastin kur apo nëse në FDT apo NJK ish kërkuar edhe trajnimi nga OE fitues për AK, për pajisjet që furnizohen, por në këtë rast nuk ka ndonjë dokument apo kërkesë për trajnim të stafit, me ç’rast, unë si ekspert shqyrtues frigohna qe eventualisht si rrjedhojë e pa aftësisë për punë te stafit (për shkak qe janë me teknologji me të avancuar) do të mbesin pa përdorur deri sa të trajnohen stafi, me siguri me shpenzime shtesë te buxhetit te institucionit. Andaj propozoj që pretendimi ankimor 1 i OE ankues për LOT 10 të aprovohet si i bazuar por te mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulimin e LOT 10.

-
- *Konstatimi i dytë (II):* Për Lot 14: OE i propozuar, në ofertën e tij, nder të tjera dokumente ka dorëzuar edhe dokumentin në formatin pdf “*K-900 Brochure katalog lot 14.pdf*”, ne të cilin dokument nuk ka asnjë informacion, specifike apo katalog për produktet përcjellëse te Auto keratorefraktometrit të ofertuar. E kjo nuk është në pajtim me kërkesat në dosjen e tenderit te prezantuar **si Fakt 1**, e po ashtu në asnjë formular B54 për korrigjim te gabimeve, e as me sqarime shtesë nuk është sqaruar e plotësuar qe për pajisjet përcjellëse/aksesoret nuk kërkohen, prandaj për mua këto kërkesa dhe deshmi dokumentare janë obligative dhe eliminuese.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues -*

-*Sa i përket ankesës 2023/0671*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te ofertave ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatoreve Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur ta lejë në fuqi vendimin e AK, saktësisht njoftimin për dhënie të kontratës të publikuar me datën 21.08.2023 nga autoriteti kontraktues, që i njëjti AK të vazhdojë me procedurën e prokurimit konform dispozitave ligjore te LPP-së lidhur me aktivitetin ne fjalë, për shkak se OE ankues nuk ka ofruar asnjë faktë sa i përket përgjegjmerisë së tij, përveç se është thirrur në publikime shkencore për të cilat deklaroi se mund të gjenden online, ndërsa vetë nuk e ka marrë mundin me i gjet dhe me i prezentu. ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, paneli shqyrtues ia fal besimin ekspertit teknik dhe përgjegjësinë e mbarëvajtjes të tërësi të aktivitetit të prokurimit duhet ta ketë AK, sipas nenit 24.2 të LPP, i cili citon: “*Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj*”

-*Sa i përket ankesës 2023/0675-*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues në super ekspertizë, ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ia fal besimin ekspertit shqyrtues sa i përket të gjeturave dhe rekomandimeve dhe ka vendosur ndërsa për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për LOT 10 dhe 14, dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Arsyeja sa i përket kthimit në ri-vlerësim të aktivitetit të prokurimit për LOT 10, paneli shqyrtues e mori për faktin se pajisja e ofruar nga OE ankues i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe po ashtu posedon teknologji më të avancuar se ajo e kërkuar. Këtë konstatim të ekspertit në super ekspertizë paneli e mbështeti, por nuk e mbështeti arsyetimin që të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulim, për shkak se sipas eksperti shqyrtues, citat "*Eksperti shqyrtues i prokurimit këtë pretendim e kish propozuar që të aprovohet si i bazuar vetëm në rastin kur apo nëse në FDT apo NJK ish kërkuar edhe trajnimi nga OE fitues për AK, për pajisjet që furnizohen, por në këtë rast nuk ka ndonjë dokument apo kërkesë për trajnim të stafit, me ç'rast, unë si ekspert shqyrtues frigohna që eventualisht si rrjedhojë e pa aftësisë për punë të stafit (për shkak që janë me teknologji më të avancuar) do të mbesin pa përdorur deri sa të trajnohen stafi, me siguri me shpenzime shtesë të buxhetit të institucionit*". Andaj, Paneli shqyrtues vlerësoj që vet AK në fazën e ri-vlerësim të bëjë një vlerësim të asaj se a ka staf të trajnuar për të përdor këtë pajisje, në të kundërtën ta anuloj aktivitetin e prokurimit për LOT 10.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP nisat gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

- Përfundim –

Bazuar shkurtimisht në faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, të analizuar nga konteksti i pavarësisë profesionale dhe kompetencave të parapara shprehimisht me dispozitën e nenit 105 të LPP, Paneli vëren se eksperti shqyrtues i ka shqyrtuar me pretendimet ankimore duke i analizuar në raport me kërkesat, kriteret dhe specifikat e parashikuara në dosjen e tenderit (DT) dhe në njoftim për kontratë (NJK) dhe me këtë rast vendosi që ta mbështes raportin e ekspertit

shqyrtues. Paneli Shqyrtues konsideron se hartimi i DT është parashikuar me dispozitën e nenit 27 të LPP dhe përbën dokumentin kryesor për të gjitha palët e përfshira në një aktivitet të prokurimit. Kurse për çdo paqartësi lidhur me kushtet dhe specifikimet e përcaktuara nga një AK në DT, secili OE ka të drejtë që sipas nenit 53 të LPP të kërkoj sqarime shtesë nga AK, natyrisht brenda afatit ligjor po ashtu të specifikuar në DT.

Prandaj bazuar në të lartcekurat dhe duke vepruar në pajtim me kompetencat e parapara me nenin 98, 99, 104 dhe 105 të LPP Paneli Shqyrtues vendosi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTERIA E SHËNDETËSISË, MINISTERIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - AGS Corporation SH.P.K., PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: